

C.nr.448/2010

GJYKATA THEMELORE NË Ferizaj -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit [REDACTED], nga Ferizaji [REDACTED], të cilin e përfaqëson avokati [REDACTED] nga Ferizaji, kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] tani me adresë të panjohur të vendbanimit të cilët i përfaqëson avokati [REDACTED] nga Ferizaji, baza juridike vërtetimi i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë me datë 24.10.2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit [REDACTED], nga Ferizaji, kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED], vërtetohet se paditësi [REDACTED] është pronarë i sipërfaqes prej 574 m², e cila sipërfaqe është pjesë e ngastres kadastrale nr.1161-0, Zona Kadastrale Ferizaj dhe e njejta ka këto kufi dhe përmasa :nga ana verilindore kufizohet me ngastrën kadastrale 1162/1, Zona Kadastrale në Ferizaji, prej pikës 1 deri te pika 5. Në anën jugore me rrugën [REDACTED] prej pikës 1 deri në pikën 13, ndërsa në anën perëndimore kufizohet me të njejtën ngastër, 1161-0, Zona Kadastrale në Ferizaj, prej pikës 13 deri te pika 6 dhe në anën veri perëndimore prej pikës 6 deri 5, me të njejtën ngastër.

II. Detyrohet paditësi [REDACTED] që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore për aktgjykim t'ia paguaj shumën e të hollave prej 20 euro.

A r s y e t i m

Pika I. [REDACTED], nga Ferizaji, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED], nga Ferizaji, tani me vendbanim të panjohur, me bazë juridike vërtetimi i pronësisë në një pjesë të ngastrës kadastrale 1161-0, Zona Kadastrale Ferizaj. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati [REDACTED], nga Ferizaji, ka kërkuar nga gjykata që të bie aktgjykimi, me përmbajtje si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me arsyetim se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërin kontestuese mbi bazën e parashkrimit fitues dhe blerjes. Paditësi [REDACTED] ka theksuar :është e vërtetë se e kam blerë paluajtshmërin kontestuese në vitin 1985, nga [REDACTED], për qmimin prej 4800 marka, të cilën shumë unë i'a kam paguar në tërësi [REDACTED], kurse [REDACTED] ma ka dorëzuar në posedim palueajtshmërin kontestuese, të cilën e shfrytëzoj që nga viti 1985 e deri në ditën e sotme, pa u penguar nga askush, në të njejtën paluejtshmëri unë fillimisht kam qelur bunar, pastaj kam ndërtuar shtëpin dhe paluejtshmëria kontestuese është e rrethuar me muri, të cilin e kam ndërtuar unë. Shtëpin në paluajtshmërin kontestuese e kam ndërtuar



Po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED] gjykata ka vërtetuar se paditësi paluejtshmërin kontestuese e shfrytëzon edhe nga viti 2000 dhe në bazë të asaj që e din dëshmitari në fjalë askush nuk e ka penguar rreth atij shfrytëzimi. Po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED], rezulton se në bazë të asaj që e din dëshmitari [REDACTED] nuk ka pasur problem me askënd rreth shfrytëzimit të paluajtshmërisë në fjalë. Kurse edhe nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED] vërtetohet faktin se paditësi [REDACTED] e ka shfrytëzuar paluejtshmërin kontestuese pa u penguar nga askush.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar në arsyetimin e këtij aktgjykimi, e vaqanarishtë gjendjen faktike të shpjeguar si në Piken II dhe III të arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhënjet Themelore Pronësore juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhen kohore në të cilën është në fuqi ky ligj.

Vendimi për taksën për aktgjykimi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë :24.10.2016



Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

